

SHTYRJE E AFATIT PËR APLIKIM PËR PROJEKTE DYPALËSHE ME REPUBLIKËN E KOSOVËS

Në zbatim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës, nënshkruar më 8.03.2010, hyrë në fuqi më datë 1.12.2011, miratuar me VKM Nr. 265 datë 21.04.2010, “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në fushat e arsimit dhe të shkencës”, Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), ka çelur thirrjet për paraqitje projekt-propozimesh dypalëshe kërkimore mes Shqipërisë dhe Kosovës, përgjatë periudhës 15.05.2019 deri më 15.08.2019.

Duke marrë në konsideratë angazhimet sezonale të kërkuesve, afati për aplikime në kuadër të Marrëveshjes në fjalë është vendosur **të shtyhet deri më datë 15.10.2019.**

Kjo thirrje është e hapur për të gjithë fushat e kërkimit shkencor dhe për të gjithë kërkuesit shkencorë.

Të gjithë të interesuarit, janë të lutur të aplikojnë duke përmbushur kërkesat dhe formularët standardë të aplikimit për projektet bilaterale.

Dokumentat do të dorëzohen në versionin *hard-copy*, pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), brenda afatit të parashikuar në këtë njoftim, **15.10.2019.**

Projekt-propozimi do të përpilohet në gjuhën shqipe dhe do të dorëzohet njëkohësisht nga partnerët e projektit në agjencitë dhe shtetet përkatëse.

Në Shqipëri projekt-propozimi, do të dorëzohet në 3 (tri) kopje dhe do të jetë i shoqëruar nga *Shkresa Përcjellëse*, e cila nënshkruhet nga titullari i institucionit kërkimor. (Lutem referojuni Marrëveshjes si më lart shënohet).

Projekt- propozimet fituese, do të financohen për një afat kohor prej 2- vitesh, me grante të ndara për secilin vitit, të cilat do të jepen sipas kërkesës dhe në përputhje me tabelen financiare bashkëlidhur në formularin e projekt- propozimit.

Shuma e grantit për secilin vit, nuk do të jetë më lartë se 3000 EUR, të cilat do të paguhen në monedhën Lek (ALL), bazuar në kursin e këmbimit në momentin e financimit.

Për formatet e projekt-propozimeve lutem referojuni lidhjes bashkangjitur kësaj thirrjeje.